# VENDIM

Nr. 117, datë 24.12.2024

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 157, DATË 18.10.2023, "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: "REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO ROMANOS - KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, FAZA E PARË", I NDRYSHUAR**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, Vendimin nr. 4071, datë 18.5.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendim nr. 1747, datë 21.7.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, Shkresën nr.8/8 prot., datë 30.4.2024, ardhur nga ASHSH-ja Tiranë, me lëndë: "Njoftim për pranimin e kërkesës për shpronësim për interes publik", Shkresën nr. 04/38 prot., datë 17.5.2024, dalë nga Bashkia drejtuar ASHSH-së, ku i bëhet me dije për situatën e krijuar pas marrjes së informacionit mbi ndryshimin e pronësisë për 12 pasuritë objekt shqyrtimi, Shkresën nr.8/20, datë 23.10.2024, dalë nga ASHSH-ja, me lëndë: "Për trajtim dhe kompetencë", Shkresën nr. 04/68 prot., datë 31.10.2024, drejtuar Sektorit të Gjendjes Civile pranë Bashkisë me kërkesë për saktësim adrese të subjektit të shpronësimit Naim Elezi, Shkresën nr. 04/73 prot., datë 12.11.2024, dalë nga Sektori i Gjendjes Civile pranë Bashkisë, me lëndë: "Kthim përgjigje", Shkresën nr. 04/74 prot., datë 14.11.2024 drejtuar ASHSH-së, Shkresën nr. 04/75 prot., datë 14.11.2024 dalë nga Bashkia Durrës, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me kërkesë për vënien në dispozicion të çertifikatës së trungut familjar të të ndjerit Naim Elezi me qëllim çeljen e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, Shkresën nr. 12455/1 prot., datë 20.11.2024 dalë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me lëndë: "Kthim përgjigje", Shkresën nr. 04/78 prot., datë 27.11.2024, drejtuar ASHSH-

së, me lëndë : "Vazhdim korrespodence", dhe sipas relacionit të pregatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 157, datë 18.10.2023, si më poshtë:

   a. Ndryshimin e listës paraprake të pronarëve që shpronësohen për interes publik nga projekti "Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos - Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, faza e parë", duke hequr nga lista e shpronësimit 12 pasuri me nr. 63/31; 63/32; 63/33; 63/34; 63/38; 63/39; 63/41; 63/42; 63/43; 63/27; 63/28; 63/29, ZK 3184, të parashikuara për shpronësim, për shkak se ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, që ndryshon pronësinë, por ky vendim nuk është regjistruar në ASHK, Drejtoria Vendore Durrës.

   b. Pakësimin e vlerës së shpronësimit, që i përkasin 12 pasurive në 1,132,930 ( një milion e njëqind e tridhjet e dy mijë e nëntë qind e tridhjet) lekë, e cila do të lëvrohet në favor të pronarit ose trashëgimtarëve të ligjshëm të përcaktuar nga dokumentacioni ligjor, pas regjistrimit të vendimeve përkatëse në ASHK, Drejtoria Vendore Durrës.

   c. Zëvendësimin e listës që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 157, datë 18.10.2023, me listën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e vendimit.

2. Deri në regjistrimin e vendimit gjyqësor në ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, pronësia juridike dhe përgjegjësia e shpronësimit mbetet e paqartë.

3. Deri në zgjidhjen e problemit të pronësisë për 12 pasuri, do të vazhdohet me procedurën e shpronësimit për pasuritë e tjera të pasqyruara në listën e shpronësimit.

4. Meqenëse është provuar se gjyqfituesi sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Vendimi 4071, datë 18.5.2015, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1747, datë 21.7.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është vendosur lënia në fuqi e Vendimit nr. 4071, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ndërruar jetë, për sistemimin e situatës ngarkohet Drejtoria Ligjore për vazhdimin e procedurave të hapjes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore për pasuritë e përfshira në këtë vendim, në mënyrë që të bëhet identifikimi i trashëgimtarëve ligjorë.

5. Ky vendim është pjesë e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 157, datë 18.10.2023, i ndryshuar.

6. Ngarkohet grupi i punës i ngritur me Urdhër nr. 552, datë 5.11.2021, i ndryshuar me Urdhrin nr. 111, datë 18.3.2022, nr. 304, datë 06.10.2023 dhe nr. 465, datë 17.12.2024, për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim i dërgohet për informacion ASHK-së, Drejtorisë Vendore Durrës .

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 26.12.2024**

REPUBLIKA E SHQIPERISË SEKRETARIA BASHKIA DURRËS

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMITNË ZONËN E PORTO ROMANOS-KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, FAZA E PARË" DURRËS

| NR | PRONARI | | | TË DHËNA HIPOTEKORE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) | | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM – ARË | | | SHËNIME (KUFIZIME HIPOTEKORE, BARRE MBI PASURINË etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati ose Qyteti | Z. Kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqa Totale | Arë (m2) | Volumi | Faqe | Sipërfaqa (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | |
| | A | B | C | D | E | F | G | H | J | K | L | P | Q | R | |
| 1 | Shahin | | Dulla | Durrës | 3184 | 70/1 | Arë | 2600 | 2600 | 10 | 183 | 326 | 554 | 180604.00 | |
| 2 | Han | Shahin | Dulla | Durrës | 3184 | 70/2 | Arë | 2600 | 2600 | 10 | 184 | 357 | 554 | 197778.00 | |
| 3 | Fatmir | | Dulla | Durrës | 3184 | 70/5 | Arë | 2600 | 2600 | 10 | 187 | 345 | 554 | 191130.00 | |
| 4 | Flamur | Shahin | Dulla | Durrës | 3184 | 70/8 | Arë | 1300 | 1300 | 10 | 190 | 241 | 554 | 133514.00 | |
| 5 | Bajram | Met | Dulla | Durrës | 3184 | 70/9 | Arë | 1560 | 1560 | 10 | 191 | 255 | 554 | 141270.00 | |
| 6 | Ahmet | | Dulla | Durrës | 3184 | 70/11 | Arë | 1300 | 1300 | 10 | 193 | 176 | 554 | 97504.00 | |
| 7 | Feride | | Oruçi | Durrës | 3184 | 70/12 | Arë | 1300 | 1300 | 10 | 194 | 192 | 554 | 106368.00 | |
| 8 | Lavdrim | Sadri | Oruçi | Durrës | 3184 | 70/13 | Arë | 650 | 650 | 10 | 195 | 167 | 554 | 92518.00 | |
| 9 | Rabije | | Oruçi | Durrës | 3184 | 70/14 | Arë | 1950 | 1950 | 10 | 196 | 324 | 554 | 179496.00 | |
| | Aferdita | | Avdia | | | | | | | | | | | | |
| | Manushaqe | | Oruçi | | | | | | | | | | | | |
| | Marime | | Oruçi | | | | | | | | | | | | |
| | Zahide | | Halili | | | | | | | | | | | | |
| | Valbona | | Shehu | | | | | | | | | | | | |
| 10 | Hamdi | Kamber | Oruçi | Durrës | 3184 | 70/19 | Arë | 2600 | 2600 | 10 | 201 | 398 | 554 | 220492.00 | |
| 11 | Arben | | Oruçi | Durrës | 3184 | 70/20 | Arë | 650 | 650 | 10 | 202 | 183 | 554 | 101382.00 | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – SEKRETARIA – BASHKIA DURRËS

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Luan | Hysen | Istrefi | Durrës | 3184 | 70/21 | Arë | 8320 | 8320 | 10 | 203 | 1168 | 554 | 647072.00 | |
| 13 | Naim | | Istrefi | Durrës | 3184 | 70/22 | Arë | 6500 | 6500 | 10 | 204 | 946 | 554 | 524084.00 | |
| 14 | Halil<br>Kadime<br>Nikolla<br>Manushaqe<br>Shyqyrie | Ramadan<br>Rrahman<br>Rrahman<br>Rrahman<br>Rrahman | Istrefaj<br>Dida<br>Sinamati<br>Peposhi<br>Lugja | Durrës | 3184 | 70/23 | Arë | 8320 | 8320 | 10 | 205 | 1167 | 554 | 646518.00 | |
| 15 | Halil | | Istrefi | Durrës | 3184 | 70/24 | Arë | 6500 | 6500 | 10 | 206 | 849 | 554 | 470346.00 | U krye rivlersim pasurie me vleren 3 601 000 |
| 16 | Zenel | | Braha | Durrës | 3184 | 70/25 | Arë | 2600 | 2600 | 10 | 207 | 456 | 554 | 252624.00 | |
| 17 | Xhelal | | Brahaj | Durrës | 3184 | 70/26 | Arë | 2600 | 2600 | 10 | 208 | 555 | 554 | 307470.00 | |
| 18 | Raiffeisen Bank SH.A | | | Durrës | 3184 | 63/115 | Arë | 22546 | 22546 | 9 | 103 | 4009 | 554 | 2220986.00 | 01545/16.06.2009-Vihet ne hip. Ne favor te Raiffaisen Bank me k/Hip dhe K/Hip nr. 3198/1255 dt. 11.06.09 Not. M. Sadushaj. 01517/11.03.2011- rivehen ne H/P ne favor te Raiffeisen Bank me K. Hip Nr. Dt. 897/453 dt. 04.03.2011. 01832/ dt. 14.04.2011- Rivehet ne H/L ne favor te Raiffeisen Bank me K. Hip. Nr. 1561/697 dt. 08.04.2011Not. A. Mallkuci. 01870/30.08.2011- Vihet ne hip ne favor te Raiffaisen Bank me k/Hip Nr. 4187/2318 dt. 29.09.11 Not. M. Sadushaj. 02114/14.02.2012-Vihet sek/pass me u. Permbarusi Nr. 1386 Prot. dt. 06.02.2013 P.Gjyqsor Privat Gelas YZO. 02534/16.09.2015Kalom pronsie ne favor te Raiff Bank + Hiqet Sekuestro nr. Vendim permarimi Nr. 7373 dt. 09.08.2015 Eps Shpk. |
| 19 | Selami | Ram | Gjocaj | Durrës | 3184 | 63/26 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 226 | 183 | 554 | 101382.00 | |
| 20 | Alush | | Thaçi | Durrës | 3184 | 63/30 | Arë | 3000 | 3000 | 7 | 114 | 455 | 554 | 252070.00 | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE SEKRETARIA DURRES

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | Arben | | Kokomani | Durrës | 3184 | 63/35 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 235 | 177 | 554 | 98058.00 | |
| 22 | Agim | Safet | Elezi | Durrës | 3184 | 63/36 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 236 | 184 | 554 | 101936.00 | |
| | Shpresa | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| | Fatos | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| | Ilir | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| 23 | Arben | | Kokomani | Durrës | 3184 | 63/37 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 237 | 151 | 554 | 83654.00 | |
| 24 | Arben | | Kokomani | Durrës | 3184 | 63/40 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 240 | 137 | 554 | 75898.00 | |
| 25 | Jak | Gege | Musteqja | Durrës | 3184 | 63/64 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 184 | 196 | 554 | 108584.00 | |
| 26 | Mark | Gege | Musteqja | Durrës | 3184 | 63/65 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 185 | 166 | 554 | 91964.00 | |
| 27 | Pjeter | Jak | Musteqja | Durrës | 3184 | 63/66 | Arë | 1000 | 1000 | 2 | 186 | 177 | 554 | 98058.00 | |
| 28 | Arben | | Kokomani | Durrës | 3184 | 63/120 | Arë | 2004 | 2004 | 10 | 141 | 316 | 554 | 175064.00 | |
| 29 | Agim | Safet | Elezi | Durrës | 3184 | 63/121 | Arë | 2004 | 2004 | 12 | 57 | 389 | 554 | 215506.00 | |
| | Shpresa | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| | Fatos | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| | Ilir | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| 30 | Agim | Safet | Elezi | Durrës | 3184 | 63/122 | Arë | 5010 | 5010 | 12 | 58 | 916 | 554 | 507464.00 | |
| | Shpresa | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| | Fatos | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |
| | Ilir | Safet | Elezi | | | | | | | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISË SEKRETARIA BASHKIA DURRËS

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | Febius | | Gerveni | Durrës | 3184 | 63/117 | Arë | 12500 | 12500 | 9 | 119 | 2236 | 554 | 1238744.00 | 01773/23.11.2010 Vihet ne favor te Raiff.bank me k.h.p nr. 5716/2166 dt. 22.11.2010 not. M. Sadushaj per shumen 80.000.000L. 01959/13.02.2012 Rivihet ne H/L ne favor te raiff.Bank me K.Hip me nr, 435/229 dt. 27.01.2012 Not. A. Mallkuçi. 02138/3.5.13vihet sekuest Urdher permb Nr. 5618 dt. 29.04.2013. Perm "eisa" J. Ahmeti. 2117/08.06.2013-Vendoset masa sekuestros me urdher permbarusi privat nr. 5609 dt. 29.04.2013 Julian Ahmeti. 2785/06.03.17-Me urdher permbarusi J. AhmetiNr. 1572 dt. 27.02.217fshihet sekuestro me nr. 5608 dt. 23.04.2013(Ref 2138 dhe 2117) 2842/03.05.2017- Fshihet H.L sipas V. Gjykates Nr. 6768 dt. 28.04.2017. |
| 32 | Sara<br>Halil | | Agalliu<br>Gashi | Durrës | 3184 | 63/118 | Arë | 12537 | 12537 | 9 | 120 | 2057 | 554 | 1139578.00 | 2458/15.04.2015 Vihet ne H/L ne favor te B.K.Tegtare Sh.A me k.Hip Nr. 2038/330 dt. 09.04.2015 Not. XH. Brahaj. 3219/20.09.2019- |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 33 | Energia B Sh.P.K | | | Durrës | 3184 | 63/119 | Arë | 56782 | 56782 | 9 | 139 | 9977 | 554 | 5527258.00 | 00927dt 08.02.2007-Vihet ne hip.ligj ne favor te "Bankes Tirana" me kont nr. 415/302/1 dt. 07.02.07., 00928 dt 08.02.07- Vihet ne hip.ligj ne favor te "Bankes Tirana" me kont nr. 416/303/1 dt. 07.02.07., 01220 dt. 18.02.08- Vihet ne hip.ligj ne favor te "Bankes Tirana" me kont nr. 619/429 dt. 13.02.08 Not. Eriketa Kokoli., 001397 dt. 18.09.2008-Rivihet ne hip ligjore ne favor te bank EFG EUROBANK ERGASIAS S.A me K. Hipot.Nr. 6303/2731 dt. 17.09.2008 Not. A. Mallkuçi per shumen 1.500.000 Euro., 01741 dt. 26.07.10 fshihet kredia me D.Not ne favor te banka EFG EUROBANK ERGASIAS A.E me Akt legalizimi dokumenti 18472 dt. 28.06.10., 02082 dt.21.11.12 Fshihen te gjitha kredite ne favor te Bankes Tirana me Dek.Not 1177/1878 dt. 19.11.12 Not. E.Kokoli., 02088 dt. 06.12.2012-Vihet ne H/L ne favor te NBG Bank me K.Hip Nr. 160/15/1296 dt. 05.12.2012 Not. E. Hoxha., 02089 dt. 06.12.2012-Rivehet ne H/L ne favor te NBG Bank me K.Hip Nr. 6072/1298 dt. 05.12.2012 Not. E. Hoxha., 02313 dt. 21.03.2014- Vihet ne H/L ne favor te Banka NBG Albania K.Hip Nr. 700/257 dt. 07.03.2014 Not. E.Hoxha. -Sipas Nenit nr. 6 te hip Ligjore nuk lejohet veprimet pa miratimin me shkrim te NBG Bank. 02680 dt. 07.11.2016- |
| 34 | Ramadan | | Voka | Durrës | 3184 | 17/59 | Arë | 5092 | 5092 | 11 | 94 | 10 | 554 | 5540.00 | |
| 35 | Shoq. Ferra &Co | | | Durrës | 3184 | 16/65 | Arë | 40502 | 5092 | 12 | 201 | 857 | 554 | 474778.00 | |
| 36 | Sokol<br>Belul<br>Gezim | Hamza<br>Muharrem<br>Tetem | Dilaj<br>Qama<br>Kapaj | Durrës | 3184 | 15/5 | Arë | 7684 | 7684 | 1 | 225 | 588 | 554 | 325752.00 | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE SEKRETARIA DURRËS

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 37 | Shtet | | | Durrës | 8517 | 2/313 | Arë | 84603 | 84603 | 30 | 114 | 147 | 554 | 0.00 | |
| 38 | Shtet | | | Durrës | 3184 | 92/2 | Ledh | 40300 | 40300 | 4 | 208 | 760 | 554 | 0.00 | |
| 39 | Fatmir | Asllan | Gega | Durrës | 3184 | 93/4 | Arë | 10500 | 10500 | 5 | 44 | 940 | 554 | 520760.00 | |
| 40 | Shtet | | | Durrës | 3184 | 96 | Ranisht | 191700 | 191700 | 4 | 212 | 5912 | 554 | 0.00 | Jepet konces,sip 3850m². Kont. Min.Transp. Shoq. Konces.Porti MRM Afat 35 vjecar Ref 2644. D-01548 dt.23.06.09- mbi këtë pasuri është regjistruar pas. 96-nd vol. 10 fq 58. 2644 dt. 30.08.16- Jepet koncesion kontrat dt. 21.07.15, me afat 35 vjecar Shoq.Konces.Port. MBM me M.Transportit dhe infrastrukturës. Nga kjo pasuri 3250 m². 03129 dt. 17.01.2019, Kip, Mbi këtë pasuri po zhvillohet proces gjyqsor me Gj,Rr.Gj Durrës. U rregj K/Padis me Nr. Regj 790 viti 2019. 3594 dt.29.06.2021-400kalojnë në pasurinë 96/13 v. 12 fq. 250. E-okupuar pjesërisht nga Flamur Kacmoli, konstatuar që nga korigjimi i hartës treguese. |
| | | | | | | | | | | | **Totali** | | | **17,853,204.00** | |

Çmimet per vleresimin e shpronesimeve jane marre nga hartat e vleres, miratuar me VKM nr. 89, dt. 03.02.2016.

**GRUPI I PUNES:** ELSA KALESHA ALNEIDA RROSHI FATJON ZEQIRI

ALEKS PRENGA ENLI KAÇULI

BASHKIA DURRES
Nr. PROT

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

**Nr.**768/6 **prot.** **Durrës, më** 31.12.**.2024**

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.117 datë 24.12.2024 "Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.157, datë 18.10.2023, "Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit, për pasuritë pronë private, që preken nga investimi publik me objekt : "rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e porto romanos - kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të durrësit, faza e parë", i ndryshuar".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS